



Komisioni Europian: Papunësia e të rinjve mund të sjellë 'fatkeqësi sociale'
Çfarë mendojnë europianët dhe amerikanët për njëri-tjetrin, dhe për botën?
Nga Londra, një mësim mbi përfitimet e Wi-Fi falas

EUROSPEAK

Buletin i Lëvizjes Europiane në Shqipëri

Nr.11, Shtator - Tetor 2012

Speciale

Integrimi: Çfarë të mbjellësh do të korrësh. Një vështrim realist drejt të ardhmes



Dihet se në Shqipëri vjeshta është periudhë shprese dhe pesimizmi bashkë. Me afrimin e 10 tetorit, datë në të cilën Komisioni Europian do të prezantojë Raportin e Progresit vjetor për Shqipërinë, debati nëse është bërë mjaftueshëm për të merituar statusin e vendit kandidat për në BE është ndezur. Ndërkohë që sinjalet nga Brukseli gjatë vitit kanë qenë jo pozitive (pasi dhe në progresin me reformat nuk ka shumë për të shënuar), me miratimin e kufizimit të imuniteteve të parlamentarëve dhe gjykatësve pak ditë më parë, Tiranën e ka pushtuar njëfarë entuziazmi. Ky akt me të vërtetë adreson njërin ndër aspektet e shumta problematike në Shqipëri, por në të vërtetë tashmë

...vijon në faqen 2 >>

Integrimi përtej dialogut politik: Sfidat e Shqipërisë për zhvillimin e burimeve njerëzore në kuadër të përfitimit nga ndihma e BE-së



Jemi mësuar që debatet publike të fokusohen në masë të gjerë tek zhvillimet politike, madje ngushtësisht tek marrëdhëniet maxhorancë – opozitë. Në një publikim të fundit, EMA risjell në vëmendje një tjetër çështje me rëndësi, ndihmën e BE-së ndaj Shqipërisë dhe sa ka përfituar ajo prej saj.

Perspektiva financiare 2007-2013 përcakton se marrja e statusit të vendit kandidat përveç se një dritë jeshile për tu afruar me familjen Europiane do ti ofrojë vendit mundësi të përfitojë nga fondet e tjera të Bashkimit Europian. Aktualisht BE-ja mbështet Shqipërinë përmes dy komponentëve të parë të IPA: Asistenca e Tranzicionit dhe Forcimi Institucional, si dhe Bashkëpunimi Rajonal dhe Ndërkufitar. Ndërkohë, me marrjen e statusit të vendit kandidat, Shqipërisë i lind e drejta të përfitojë edhe nga tre komponentët e tjerë si: Zhvillimi Rajonal, Zhvillimi i Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimi Rural.

...vijon në faqen 4 >>

Shqipëria e përfaqësuar përmes artit



Intervistë me sopranon Ermonela Jaho

EuroSpeak: Znj. Jaho, Edhe pse në moshë të re, ju keni bërë një rrugë të gjatë artistike. Sa e vështirë është për një artist që vjen nga një vend i vogël dhe i varfër të realizohet në nivel ndërkombëtar? A mund të na përmendni momentin(et) që kanë lënë më shumë gjurmë në rrugëtimin tuaj?

Ermonela Jaho: Një proverb i lashtë kinez thotë "Një udhëtim prej 1000 miljesh fillon me një hap të thjeshtë". Çfarëdo lloj rruge që të duket e vështirë dhe e pamundur është e realizueshme nëse i dedikoheshme gjithë qenien tënde duke e konsideruar artin e këndimit si oksigjeni që thith për ditë. Që nga ai moment, vështirësitë e dokumenteve, udhëtimeve,


...vijon në faqen 5 >>



Speciale

Integrimi: Çfarë të mbjellësh do të korrësh. Një vështrim realist drejt të ardhmes

...vijon nga faqja 1 >>



Karikatura: Rael Hoxha

debati dhe argumentet duket se nuk janë shumë të fokusuar tek arritjet objektive në adresimin e 12 rekomandimeve. Ekziston një mendim deri diku i përhapur që Shqipërisë duhet t'i jepet një dritë shprese për të ardhmen në BE kësaj here, pasi mbushen 100 vite nga shpallja e pavarësisë. Një argument pro dhënies së statusit ka të bëjë dhe me faktin se dështimet e akumuluar vitet e

mëparshme, mund ta kompleksojnë dhe zhysin në pesimizëm vendin karshi fqinjëve të cilët kanë shënuar të gjithë njëfarë progresi (Mali i Zi në qershor nisi negociatat me BE-në, Serbia në pranverë mori statusin dhe së fundmi dhe Kosova ka marrë udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave). Edhe pse të ndërgjegjshëm për vlefshmërinë e këtyre argumenteve "më abstrakte", qarqet diplomatike në Tiranë shprehen se sërish ndihen në siklet dhe të pavendosur me Shqipërinë deri në momentin e fundit. Arsyeja? Po të shihet nga perspektiva e përmbushjes së detyrimeve dhe realizimit të reformave, arritjet janë të pakta dhe ndonjëherë në momentin e fundit, pasi është humbur i gjithë viti. Gjithsesi, historia e integrimit europian dhe ajo e zgjerimit në veçanti, kanë treguar se faktorë të shumtë rrethorë politikë ndërhyjnë në vendime të tilla. Por le të hedhim një sy mbi nivelin e përmbushjes së detyrave të Shqipërisë aktualisht.

Perspektiva për të marrë statusin e vendit kandidat, e parë nga pikëpamja e nivelit të përmbushjes së 12 rekomandimeve

1. Të garantohet funksionimi i duhur i Parlamentit, mbi bazën e një dialogu politik konstruktiv dhe të qëndrueshëm midis të gjitha partive politike.
 - Nuk janë bërë ndryshime në rregulloren e Kuvendit
 - Nuk ka një angazhim konkret nga forcat politike për të adresuar këtë rekomandim në javët e ardhshme
2. Të miratohen ligjet e mbetura pezull që kërkojnë shumicë të cilësuar në Parlament
 - + Janë miratuar ligjet me shumicë të cilësuar të mbetura pezull
3. Të emërohet Avokati i Popullit, dhe në Parlament të bëhet proces i rregullt dëgjimor dhe proces i rregullt votimi për emërimet në Gjykatën Kushtetuese dhe në Gjykatën e Lartë.
 - + Avokati popullit është zgjedhur
 - Ende nuk është zgjidhur ngërçi ligjor mbi emërimet në Gjykatën Kushtetuese dhe në Gjykatën e Lartë.



- 4. Të bëhen ndryshimet në kuadrin ligjor për zgjedhjet, sipas rekomandimeve të OSBE-ODIHR.**
- 5. Të garantohet mbajtja e zgjedhjeve në pajtim me standardet evropiane e ndërkombëtare.**
 - + Kodi zgjedhor është miratuar në datë 19 korrik 2012.
 - Nuk është zgjedhur Kryetari i ri i KQZ-s, ndonëse ka kaluar afati kushtetues.
- 6. Të kryhen hapat thelbësorë të reformës në administratën publike, përfshi ndryshimet në ligjin për shërbimin civil dhe forcimin e Departamentit të Administratës Publike, me synim që të rritet profesionalizimi dhe depolitizimi i administratës publike, si edhe të forcohet qasja që emërimet dhe ngritjet në detyrë të bazohen në transparencë dhe merita**
 - Ligji i ri për nëpunësit civil nuk është miratuar ende.
 - Zbatimi i legjislacionit në fuqi mbetet i dobët.
- 7. Forcimi i shtetit të së drejtës nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të një strategjie për reformën në drejtësi që garanton pavarësinë, eficientë dhe përgjegjësinë e institucioneve të drejtësisë.**
 - Ligje të rëndësishme për sistemin e drejtësisë nuk janë miratuar ende (Ligji për Gjykatën e Lartë, Këshillin e Lartë të Drejtësisë, etj.)
 - + Procesi i aplikimit të teknologjisë së informacionit (IT) ka lehtësuar menaxhimin e çështjeve në gjyqësor.
- 8. Të zbatohet me efektivitet Strategjia anti-korrupsion e qeverisë dhe plani i veprimit, si dhe të hiqen pengesat ndaj hetimeve, sidomos për hetimet e gjyqtarëve, ministrave dhe deputetëve; të krijohet një historik solid me hetimet pro-aktive, ndjekjen dhe dënimin e çështjeve të korrupsionit në të gjitha nivelet.**
 - + Ndryshimet ligjore për kufizimin e imunitetit u miratuan në 18 shtator 2012
 - Niveli i ulët i rasteve të dënimit të korrupsionit, veçanërisht të atij me profil të lartë.
- 9. Të forcohet lufta kundër krimit të organizuar, bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe hetimit proaktiv, rritjen e bashkëpunimit me partnerët rajonalë dhe të BE-së dhe koordinimin më të mirë të agjencive të zbatimit të ligjit. Të krijohet një historik solid në këtë fushë.**
 - + Përmirësim i rezultateve në luftën kundër trafikut të drogës dhe krimit të organizuar si dhe rritje e numërit të hetimeve proaktive.
 - + Përmirësime në kuadrin ligjor.
 - Mungesë rezultatesh në luftën kundër pastrimit të parave dhe bllokimit të aseteve me burim veprimtarinë e jashtëligjshme.
- 10. Një Strategji Kombëtare dhe Plan Veprimi në lidhje me titujt e pronësisë duhet të përgatiten, miratohen dhe zbatohen, në konsultim të gjerë me grupet e interesit dhe duke marrë parasysh praktikat ligjore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEtDNj); kjo iniciativë duhet të marrë në konsideratë proceset e kthimit, kompensimit të pronave dhe atë të legalizimit të ndërtimeve informale.**
 - + Strategjia Reforma në Fushën e të Drejtave të Pronësisë u miratua në Qershor 2012.
 - Pak progres për qartësimin e kuadrit ligjor të pronësisë.
 - Vazhdon të rritet numri i çështjeve të pronësisë të gjykuara në dëm të Shtetit shqiptar nga Gjykata e Strasburgut.
- 11. Të bëhen hapa konkrete në forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, sidomos të grave, fëmijëve dhe romëve, si dhe në zbatimin efektiv të politikave anti-diskriminim.**
 - Angazhim i pakët dhe sporadik i institucioneve qeveritare duke e parë këtë çështje si detyrë të organizatave joqeveritare.
- 12. Përmirësimi i trajtimit të të ndaluarve dhe të burgosurve.**
 - + Ligji i ri për Shëndetin Mendor u miratua në Prill 2011.
 - + Ka patur zhvillime pozitive në përmirësimin e infrastrukturës së institucioneve të vuajtjes së dënimit.

Integrimi përtej dialogut politik: Sfidat e Shqipërisë në kuadër të përfitimit nga komponenti IPA IV

...vijon nga faqja 1 >>

Komponenti i katërt i IPA-s, Zhvillimi i Burimeve Njerëzore shërben si një fazë tranzitore për të përgatitur kapacitetet administrative dhe institucionale të vendit për menaxhimin e fondeve strukturore, përkatësisht Fondin Social Europian. Bazuar në Strategjinë Europiane të Punësimit dhe Europa 2020, akset prioritare të zhvillimit të burimeve njerëzore janë:

- Tërheqja dhe mbajtja e sa më shumë njerëzve në tregun e punës;
- Përmirësimi i përshtatshmërisë dhe fleksibilitetin të punëtorëve dhe ndërmarrjeve përmes edukimit;
- Forcimi i përfshirjes sociale nëpërmjet integrimit të njerëzve të pafavorizuar në tregun e punës.

Në dallim nga dy komponentët e parë të IPA-s, zhvillimi i burimeve njerëzore ka një tjetër natyrë për sa i përket menaxhimit dhe përfituesve. Menaxhimi i fondeve nën këtë komponent do të kalojë vetëm përmes sistemit të decentralizuar (DIS), çka nënkupton transferimin e përgjegjësive nga

strukturat Europiane tek ato vendase. Autoritetet shqiptare do të jenë përgjegjëse për programimin, tenderimin, procedurat e thirrjeve për aplikime, kontraktimin, e deri tek pagesat dhe monitorimi i zbatimit të fondeve IPA. Marrja e përgjegjësive për DIS e fondeve IPA IV, kërkon që autoritetet shqiptare të akreditohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Punësimit e Komisionit Europian, si të afta për të administruar në mënyrë të pavarur asistencën financiare të BE-së. Në kontrast me dy komponentët e parë të IPA-s, rrethi i përfituesve nga fondet IPA IV zgjerohet. Kjo për shkak se politikat stimulojnë të punësimit dhe rritja e aksesit në tregun e punës për kategori të ndryshme individësh përmes edukimit dhe arsimit profesional, kërkon domosdoshmërisht ndërveprim mes institucioneve dhe agjensive publike, sektorit privat, shoqërisë civile, sindikatave dhe komunitetit të biznesit.

Përgatitjet e Shqipërisë për përfitimin nga fondet e komponentit IPA IV

Procesi i programimit në kuadër të fondeve IPA IV ndikohet jo pak nga zhvillimet politike të vendit.

PËRFITUESIT POTENCIALË

Maqedonia	Shqipëria
Agjensia e Shërbimit të Punësimit & qendrat e punësimit	Shërbimi Kombëtar i Punësimit & zyrat e punës
Autoritetet vendore (kryesisht bashkitë)	Autoritetet vendore (bashkitë)
Qendra për Arsim & Trajnim profesional	Agjensia e Arsimit dhe Formimit Profesional; qendrat e formimit profesional
Dhomat e Tregtisë	Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë (Dhoma Amerikane e Tregtisë, Dhoma Britanike, BiznesAlbania, Konfindustria, etj.)
Dhomat Artizanale të tregëtisë	Shoqatat artizanale, Bashkimet e zanatçinjve
Organizatrat për edukimin e komunitetit Rom	Organizatrat për edukimin e komunitetit Rom
Bizneset e Vogla dhe të Mesme	Bizneset e Vogla dhe të Mesme
Sindikatat	Sindikatat (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura, Sindikata e Pavarur e Arsimit, e Shëndetësisë, Sindikatat e Minatorëve)
Shkollat profesionale	Shkolla Teknike Ekonomike, Hoteleri Turizëm ,etj.
Organizata të Shoqërisë Civile	Organizata të Shoqërisë Civile
Institucionet e Arsimit dhe Trajnimit	Institucionet arsimore (Private dhe Publike)
	Instituti i Trajnimit të Administratës Publike

Dështimi në 2011 për të dytën herë në marrjen e statusit të vendit kandidat ka ndikuar negativisht në motivimin e administratës publike. Ndonëse puna përgatitore në këtë drejtim ka vazhduar, ritmi i saj nuk është në nivelin që mund të ishte nëse vendi do gëzonte statusin kandidat dhe vetëm aftësia e administratës do të kushtëzonte marrjen e fondeve. Mungesa e presionit të statusit të vendit kandidat ndikon drejtpërdrejtë në nxitjen dhe motivimin e administratës dhe shpejtësinë me të cilën realizohen këto procese. Nga ana tjetër, i gjithë ky cikël përgatitjesh të dokumenteve strategjik ka shërbyer në vetvete si një ushtrim për administratën shtetërore. Të mësuarit përmes ushtrimit ka ndikuar në rritjen e cilësisë së punës së administratës publike në programimin e fondeve IPA, reflektuar kjo përmes hartimit të projekteve më cilësore.

Hartimi i Kuadrit të Koherencës Strategjike dhe Programeve Operacionale ka qenë një sfidë për administratën publike për shkak të kompleksitetit të procesit si dhe kapaciteteve të saj të kufizuara. Profesionalizmi dhe aftësitë menaxheriale të administratës publike janë përcaktues të suksesit në programimin e fondeve IPA. Mirëpo, në disa raste administrata publike është përballur me mungesën e stafit të mjaftueshëm, profesionalizmit, si dhe qëndrueshmërisë së stafit në punë. Gjithashtu, mungesa e transparencës në raport me publikun për sa i përket shkëmbimit të informacionit mbi dokumentet e programimit nuk kontribuon në rritjen e pronësisë së përfituesve mbi këtë proces. Përpos ngritjes dhe zbatimit të kuadrit institucional dhe ligjor, në kuadër të së cilave Shqipëria ka ndërmarrë hapa pozitiv, përfitimi nga fondet e IPA IV dhe në të ardhmen nga Fondi Social European do të përcaktohet nga kapacitetet përthithëse që do të ketë vendi. Eksperiencia e vendeve fqinje si Maqedonia apo edhe vetë përvoja jonë deri më tani ka dëshmuar se ka një diferencë të konsiderueshme mes fondeve që alokohen dhe atyre që përthithen. Ndaj forcimi i kapaciteteve përthithëse paralelisht ndaj atyre programuese duhet të jetë një prioritet jo vetëm i qeverisë qendrore por dhe i institucioneve vendore, të cilat do jenë tërësisht të përfshira në proces.

Rekomandime për aktorët shtetërorë:

- T'i japin më shumë rëndësi procesit të konsultimit publik si një mundësi për gjithëpërfshirje duke rritur pronësinë mbi këtë proces. Konsultimi duhet të jetë intensiv që kur programimi është në fazën embrionale pasi vetëm kështu ai do të jetë një proces i shëndetshëm dhe i vlefshëm.
- Të rrisin ndërveprimin dhe të konsolidojnë bashkëpunimin me përfituesit si një mënyrë për të përmirësuar programimin e asistencës financiare në të ardhmen.
- Të ndërmarrin masa për forcimin e kapaciteteve përthithëse të fondeve IPA nga përfituesit përmes kurseve apo trajnimeve, jo vetëm në Tiranë por me shtrirje dhe në qendrat kryesore të vendit.
- Të sigurojnë një lidhje më të fortë mes asistencës financiare dhe strategjive sektoriale si mënyrë për një racionalizim sa më të mirë të fondeve IPA.
- Të realizojnë një planifikim në kohë të asistencës së ardhshme financiare me qëllim për të rritur ndikimin dhe efektivitetin e saj. Meqenëse perspektiva e re financiare IPA II 2014 – 2020 do të bazohet mbi të njëjtën qasje sektoriale, kjo përben një avantazh për strukturat e përgjegjëse që eksperiencën e akumuluar ta vënë në shërbim të përmirësimit të programimit të fondeve IPA.

Stafi i EuroSpeak, shtator 2012

Shqipëria e përfaqësuar përmes artit **Intervistë me sopranon Ermonela Jaho**

...vijon nga faqja 1 >>

gjuhëve, mentaliteteve, vështirësitë financiare, vetmia, nënvleftësimi e të tjera kthehen ashtu si zurma e një mjeti në lëvizje, në një element që është pjesë e pandarë e rrugëtimit të zgjedhur profesional. Për sa u përket momenteve të veçanta, mendoj se janë jashtëzakonisht të shumta. Në fund të fundit çfarë vlere ka qëndrimi për disa momente në majë të malit, në qoftë se çdo moment i rrugës ka qenë i mjerueshëm?

...vijon nga faqja 5 >>

EuroSpeak: Si e gjykoni rolin e një artisti: mendoni se në këtë botë kaq ndërkombëtare dhe të globalizuar ai përfaqëson veten apo ende vlen ideja e lidhjes me vendin e origjinës dhe përfaqësimit të tij? Në këtë kuptim, a e keni menduar ndonjëherë veten si një ambasadore shqiptare që mund të përmirësojë imazhin e vendit ndërkohë që kjo detyrë nuk po realizohet mirë nga politikanët dhe diplomatët?

Ermonela Jaho: Unë mendoj se një artist i vërtetë duhet të nisët nga vetvetja, të pasurohet nga ngjyrat e vendit ku formohet, por duhet të përfundojë në zemrën e gjithë njerëzimit. Çfarë vlere ka përvoja ime humane në qofte se nuk arrin dot të prekë askënd? Është e pamundur për një individ të jetë një krijesë që i përket vetëm vetvetes dhe të mos ketë asnjë lloj influence nga ambientet ku ka jetuar. Nuk ka kuptim të ndash një rezultat nga shuma e gjithë pjesëve përbërëse të tij. Unë jam e bindur se në qoftë se arrij të prodhoj një vlerë artistike me cilësi të lartë për tu paraqitur në botë kam prezantuar jo vetëm veten time, por edhe formimin tim pjesë e pandarë e të cilit është padyshim dhe vendi im. Besoj se ka një arsye përse francezët i kategorizojnë verërat sipas tokës nga të cilat e kane origjinën...

EuroSpeak: Cila është ëndrra, sfida për të ardhmen për një artiste që tashmë ia ka dalë të këndojë në skenat më të rëndësishme botërore?

Ermonela Jaho: Sfida e përhershme e një artisti është të qëndrojë vetvetja. Është një pikësynim që fillon e bëhet më i vështirë për tu arritur në momentin që je i suksesshëm komercialisht. Duke kujtuar fjalët e shkrimtarit Ernest Hemingway "lexova sot se çfarë kisha shkruar mbrëmë dhe kuptova që nuk di të shkruaj. Por fatkeqësisht nuk e lë dot profesionin sepse jam tepër i famshëm tashmë". Shpresoj të mos bie pre e madhështisë sipërfaqësore dhe të braktis rrënjët e mia si artiste. Uroj që dëshira për të ndjekur më të bukurën të mos shuhet kurrë tek unë, sepse nëpërmjet kësaj dëshire pasurohem me shumë si qenie njerëzore. Nuk besoj se duhet t'i trembem shumë perfeksionit, sepse siç shprehej piktori spanjoll Salvador Dali, është i pamundur për tu arritur...

Kartolina nga BE-ja

Rumania dhe Bullgaria "kanë humbur shansin" për të përdorur fondet e BE-së

Sipas një raporti të Senatit Francez, vonesat e Rumanisë dhe Bullgarisë që nga anëtarësimi i tyre në vitin 2007 për të përdorur fondet e BE-së kanë penguar zhvillimin e demokracisë dhe ekonomisë së tregut në këto vende. Në buxhetin 2007-2013 të BE-së, 19.7 miliardë euro i janë dhënë Rumanisë dhe 6.9 miliard euro Bullgarisë. Por Rumania ka qenë në gjendje për të absorbuar, deri në janar 2012, vetëm 4 për qind të këtyre fondeve, ndërsa Bullgaria 19 për qind për të njëjtën periudhë.

Senatorët francezë ia atribuojnë arsyet për pamundësinë e vendeve për të investuar fondet e BE-së "mungesës së përvojës", "mungesës së kapaciteteve administrative dhe gjyqësore", dhe "praktikave mashtruese" të vazhdueshme. Raportet e fundit të Komisionit Europian mbi Rumaninë dhe Bullgarinë, të publikuara më 18 korrik, janë kualifikuar si "jashtëzakonisht negative" për Rumaninë dhe "pak më shumë dashamirëse" për Bullgarinë.

Nga ana tjetër, në një intervistë të dhënë për Wall Street Journal më 3 shtator, kryeministri Bullgar, Boyko Borisov, dhe ministri i financave, Simeon Djankov, kanë përjashtuar çdo mundësi që Bullgaria të bëhet pjesë e eurozonës në vitet e ardhshme, megjithëse kishin premtuar futjen e euros brenda vitit 2013. Sipas tyre ky vendim erdhi si rezultat i krizës dhe recesionit që ka pushtuar eurozonën. Bullgaria tashmë i plotëson kriteret ekonomike për tu bashkuar me euron, pasi ka ulur deficitin e saj buxhetor në 2.1 për qind në vitin 2011, kur kufiri i kërkuar është 3 për qind.

Stafi i EuroSpeak, shtator 2012

Katalonia e Spanjës do t'i kërkojë Madridit 5 miliard euro për të shpëtuar nga kriza



Katalonia, krahina autonome Spanjës, e cila gjeneron rreth një të pestën e prodhimit ekonomik të shtetit, ka thënë se do të kërkojë

kredi emergjente prej 5 miliardë eurosh nga Madridi, duke rritur frikën e borxhit dhe kolapsit financiar.

Qeveria e Katalonias, me një borxh prej 48 miliard eurosh, ka deklaruar se nuk mund të marrë më hua në tregjet financiare për të mbështetur borxhin e saj, dhe për këtë do të kërkojë ndihmë nga fondi rajonal i shpëtimit për Spanjën. Katalonia, pas Valencias dhe Murcias, do të bëhet krahina e tretë, nga 17 rajonet autonome të Spanjës, e cila do të kërkojë zyrtarisht ndihmë nga fondi i shpëtimit të qeverisë prej 18 miliard Eurosh.

Qeveria e Mariano Rajoy po lufton për të përmbushur angazhimet e saj buxhetore në eurozonë dhe për të shmangur një shpëtim të stilit grek. Tashmë, Europa është angazhuar për t'i dhënë hua Spanjës deri në 100 miliard euro, për të mbështetur sistemin e saj bankar. Fati i Spanjës për të evituar paketën e plotë të shpëtimit nga BE-ja varet pjesërisht nga efektiviteti i krahinave të saj më të fuqishme për t'iu përmbajtur skemave të reja buxhetore. Fakti që një krahinë si Katalonia nuk mund të përmbushë detyrimet e financimit të borxhit të saj, është një problem shqetësues për vendin në këtë moment.

EurActiv, 29 gusht 2012

Papunësia e të rinjve mund të sjellë 'fatkeqësi sociale'

Rritja e papunësisë së të rinjve në disa shtete anëtare të BE-së mund të përbëjë një "kërcënim serioz për kohezionin social", paralajmëroi Komisioni European në 31 gusht.

"BE-ja, institucionet, qeveritë, bizneset dhe partnerët e veçantë të të gjitha niveleve duhet të bëjnë ç'është e mundur për të shmangur një "brez të humbur" që do të ishte një katastrofë ekonomike dhe sociale," tha në një deklaratë komisioneri i BE-së për punësimin Laszlo Andor.

Paralajmërimi erdhi pasi zyra statistikore e BE-së, Eurostat, publikoi shifra që tregojnë se papunësia e të rinjve në eurozonë ra në dhjetë shtete anëtare, ndonëse ka pësuar rritje të mëdha në Greqi, Spanjë dhe Qipro.

Si Greqia dhe Spanja tani kanë numrin më të lartë të të rinjve të papunë, me 53,8 për qind dhe 52,9 për qind respektivisht. Gjermania dhe Austria kanë

nivelin më të ulët, 8 për qind dhe 8.9 për qind. Greqia, Irlanda, Italia, Letonia, Lituania, Portugalia, Sllovakia dhe Spanja janë përfitues të Fondit Social European në një projekt pilot të nisur në fillim të këtij viti. Papunësia e të rinjve në secilin prej këtyre vendeve është mbi 30 për qind.

Matjasic, president i European Youth Forum vlerëson projektin e Komisionit, Garantimin i të Rinjve që synon t'u gjejë të rinjve punësim, trajnim ose ri-trajnim brenda katër muajve që prej humbjes së vendit të punës. "Investimi 10 miliard Euro në Garantimin e të Rinjve mund të heqë 2 milionë njerëz nga regjistri i papunësisë deri në vitin 2014", pohon Matjasic.

EU Observer, 31 gusht 2012

Shefi i inteligjencës: Kryeqyteti i BE-së është "kryeqyteti spiun"

Për Alain Winants, kreu i Shërbimit të Sigurimit të Belgjikës (VSSE), kryeqyteti i BE-së aktualisht ka më shumë aktivitet spiunazhi se pothuajse çdo qytet tjetër në botë. Winants tha për EUobserver në një intervistë të rrallë me median ndërkombëtare se "këtu nuk bëhet fjalë për dhjetëra, por për qindra, disa qindra" oficerë të zbulimit të huaj dhe agjentë në Bruksel.

"Në Belgjikë spiunazhi si ai rus, kinez, iranian dhe nga vende të tjera, është në nivelet e Luftës së Ftohtë. Ne jemi një vend me një përqendrim të madh diplomatësh, biznesmenësh dhe institucionesh ndërkombëtare. Si një oficer zbulimi, mund të them që për një spiun ky vend është parajsja" tha ai. Kur u pyet nëse vendet mike të BE-së, si Izraeli apo SHBA, mund të kryejnë këtë aktivitet, ai tha: "Do të ishte naive të mendojmë se të vetëm vende si Rusia, Kina apo Irani spiunojnë."

Sipas tij, spiunët zakonisht pretendojnë të jenë diplomatë, gazetarë, lobistë, biznesmenë apo studentë. Përveç mbledhjes së informacionit, ata përpiqen të ndikojnë në vendimet e marra nga zyrtarët e lartë të BE-së apo NATO-s. VSSE është kryesisht përgjegjëse për luftën kundër terrorizmit. Por pjesë e punës së saj është të mbrojë institucionet ndërkombëtare.

Shërbimi i jashtëm i BE-së është formuar dhe vepron që prej 18 muajsh. Ky shërbim ka rreth 40 zyrtarë



përgjegjës për sigurinë në selitë e BE-së dhe afërsisht 90 që kujdesen për delegacionet e huaja. Kompetenca e shërbimeve të sigurisë së institucioneve të BE-së është e kufizuar në mjediset e tyre. Pra, kur aktiviteti zhvillohet jashtë ambienteve të BE-së, atëherë VSSE është në kompetencë të plotë” shpjegoi Winants.

Në vitin 2009, Simm, një zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes estoneze, i cili ishte në krye të shkëmbimit të informacionit të klasifikuar me BE-në dhe NATO-n, u burgos sepse u zbulua se ishte spiun rus.

Stafi i EuroSpeak, shtator 2012

Ecejaket Bruksel – Strasburg duhet të marrin fund!

Me rinisjen e punës në Parlamentin Europian në shtator janë rikthyer si përhërë dhe debatet mbi selinë e tij të dyfishtë, në Bruksel dhe Strasburg (madje të trefishtë, po të marrim parasysh dhe sekretariatit në Luksemburg). Sipas traktatit, anëtarëve të Parlamentit Europian dhe stafit mbështetës, u kërkohet të mblidhen një herë në muaj në Strasburg. Pavarësisht rëndësisë simbolike që Franca i atashon kësaj selie të Parlamentit Europian dhe institimit të saj që ajo të vazhdojë të ekzistojë, të shumta janë disavantazhet. Shpeshherë debatet mbi çështje të rëndësishme zbehen, pasi europarlamentarët hezitojnë të paraqiten në seancat në Strasburg. Gjithashtu ndër vite, kanë lindur dhe pakënaqësi të stafit për ecejaket. Por mbi të gjitha, duket se problemet qëndrojnë tek kostot e mbajtjes së kësaj selie. Në fakt, sipas revistës Public Service Europe, përlllogaritet që selia në Strasburg u kushton qytetarëve europianë rreth 200 milionë euro në vit. Po sipas këtij burimi, i konsiderueshëm është dhe impakti në ambient, pasi vlerësohet se po të mos ndodhnin spostimet nga Brukseli në Strasburg, do të lëshoheshin në ambient rreth 1. 600 ton dioksid karboni në vit më pak, do të kursehej dërgimi i tonelatave dokumentesh në letër, etj. Aktualisht, po shqyrtohet mundësia e reduktimit të numrit të takimeve të Parlamentit Europian në selinë e Strasburgut, por ende jo mbyllja e saj.

Stafi i EuroSpeak, shtator 2012

Dy të tretat e francezëve janë pesimistë për të ardhmen



Presidenti i ri socialist dhe një qeveri e re e majtë nuk i kanë bërë francezët më të lumtur. Këto të dhëna kanë dalë nga një sondazh me qytetarët francezë ku dy të tretat janë treguar pesimistë për të ardhmen. Në sondazhin e kryer tre muaj pasi François Hollande fitoi presidencën, 68 për qind e atyre që u pyetën thanë se ishin të shqetësuar për veten dhe familjen e tyre.

Niveli i “zymtësisë” është afër me të dhënat më të këqija të regjistruara ndonjëherë, ato të vitit 2005 menjëherë pasi Zhak Shirak u zgjodh për një mandat të dytë, kur pesimizmi kishte pushtuar 70 për qind të njerëzve. Paraardhësi i Hollande si president, i djathti i qendrës Nikolas Sarkozy, kishte bërë vetëm 50 për qind të popullsisë të frikësohej për të ardhmen.

Dimanche Ouest France, gazeta që porositi studimin, tha se 2005 ka qenë një “kulmim historik i pesimizmit të matur” dhe se më pesimistët ishin personat mbi 65 vjeç, biznesmenë të vegjël, gratë dhe të papunët ndërsa më optimistët ishin punëtorët. “Është hera e parë që shqetësimi është aq i lartë që në fillim të mandatit presidencial,” raportoi anketuesi i Ifop. Nuk janë vetëm mbështetësit e opozitës që shohin re të errëta përpara: 58 për qind e mbështetësve të Partisë Socialiste u shprehen se nuk kishin ndjerë më shumë optimizëm me gjithë ardhjen e të majtës në pushtet për herë të parë mbas 15 vitesh.

The Guardian, 2 shtator 2012

Nga Londra, një mësim mbi përfitimet e Wi-Fi falas

Gjatë lojrave Olimpikë në Angli, përveç atmosferës gjallëruese, mund të vihej re edhe një valë e madhe e shërbimit Wi-Fi të ofruar falas. Mundësuar nga operatorët kryesorë telefonikë, shërbimi Wi-Fi u ofrua falas gjatë kësaj periudhe në sheshet më të mëdha publike, në stacionet e trenit, metrotë dhe aeroportet.

Ofrimi falas i këtij shërbimi po bëhet gjithmonë e më shumë një praktikë e ndjekur nga operatorët telefonikë për të ruajtur cilësinë e shërbimeve telefonike në kohët kur ka mbingarkim rrjeti apo trafik të dhënash, si edhe për të shmangur tarifatat stratosferike të shërbimeve roaming.

Rrjetet publike Wi-Fi tani mund të gjenden në shumicën e qyteteve të mëdha. Sipas *Informa*, një firmë hulumtuese, numri i pikave Wi-Fi në mbarë botën do të arrijë në 5.8 milion deri në fund të vitit 2015, nga 800,000 në vitin 2010. Tetë nga dhjetë operatorët më të mëdhenj botërorë po përdorin Wi-Fi për të liruar trafikun e tyre të të dhënave.



Shërbimi, i cili u përdor nga 12 milionë njerëz gjatë Lojrave Olimpikë, fillimisht ishte pa pagesë për të gjithë konsumatorët. Duke filluar nga shtatori ky shërbim do të ofrohet kundrejt një tarife për konsumatorët e kompanive të tjera. Philip Kendall, analist në Strategy Analytics në Londër, pret një përshpejtim në përhapjen e zonave Wi-Fi si pasojë e konkurrencës së fortë midis operatorëve. Sipas tij, kjo është një mënyrë mjaft e mirë për të qenë më efektivë për sa i përket kostove të zgjerimit të mundësive dhe kapaciteteve për shërbimet e të dhënave telefonike.

The New York Times, 2 shtator 2012

Në pritje të aderimit...

Ballkani perëndimor: periferia e periferisë...

Në një analizë të shkëlqyer të situatës, Dimitar Bechev, studiues i European Council on Foreign Relations, argumenton se “kriza e BE-së nuk e ka shuar zgjerimin, por po e çon rajonin e Ballkanit Perëndimor në rrethin më të jashtëm të një Europe me shumë shpejtësi – duke e bërë kështu periferinë e periferisë”. Me ekonomitë e Ballkanit që shënojnë rritje të dobët ekonomike e në disa raste dhe rënie, kjo krizë ka nxjerrë në pah kufizimet e modelit europian të zhvillimit, duke e thyer mitin e konvergencës së BE-së me rajonin.



Sipas, Bechev “kriza përforcon më tej tundimin që ekzistonte tashmë në BE për të ndjekur një qasje ‘të shohim e të bëjmë’ për Ballkanin Perëndimor. Por ky stabilitet në dukje dhe *status quo*-ja e tej zgjatur mund të shkaktojë zhgënjim. Stanjacioni brenda rajonit gërryen ndikimin e BE-së dhe inkurajon vende konkurrencte. Për të bërë që zgjerimi të funksionojë dhe të rivendosë fuqinë e saj të butë, BE-ja duhet të zhvendosë fokusin nga një narrativë e bazuar tek siguria tek një e bazuar në ekonomi. BE-ja ka nevojë për vendosë strategjikisht burimet e saj të pakta, së bashku me aktorë të tjerë ndërkombëtare si FMN, për të shmangur një situatë të veshtirë ekonomike dhe për të ndihmuar rritjen ekonomike. Në fund për Bechev “BE-ja mund të jetë ende zgjidhja, dhe jo problemi në Ballkanin Perëndimor - por vetëm në qoftë se ajo nuk e heq atë nga rendi i ditës sa i takon zgjerimit të saj politik”.

Stafi i EuroSpeak, shtator 2012



UNESCO pret Shqipërinë në Ekspozitën e Arkitekturës në Venecia



Byroja Rajonale e UNESCO-s për Shkencën dhe Kulturën në Europë priti për herë të dytë pavijonin shqiptar në Ekspozitën e 13 Ndërkombëtare të Arkitekturës në Venecia. Yolanda Valle-Neff, drejtore e Zyrës Rajonale të UNESCO-s për Shkencën dhe Kulturën në Europë, në inaugurimin e pavijonit, tha se ky demonstrim, pavarësisht historisë së kombit dhe njerëzve të tij, thekson trashëgiminë si një vlerë mbi të cilën gjithmonë duhet të ndërtohet e ardhmja. “Mbrotjtja e trashëgimisë nuk konsiston vetëm në mbrojtjen e vendeve me vlerë të jashtëzakonshme për edukimin e brezave të ardhshëm, por më e rëndësishmja është se nxit dialogun midis kulturave dhe është themeli për pajtimin dhe zhvillimin e shoqërive” shtoi ajo. Kjo është hera e dytë që Shqipëria merr pjesë në Ekspozitën Ndërkombëtare të Arkitekturës në Venecia. Hera e parë, ishte në vitin 2010. Ekspozita fton vizitorët t’i rikthehen koncepteve të trashëgimisë kulturore dhe planifikimit të qytetit, si dhe paraqiti disa nga vendet më interesante në Shqipëri.

BalkanInsight, 28 gusht 2012

Kosovës i duhet të ndërtojë partneritet të veçantë me Gjermaninë



Gjermania, ekonomia më e fortë e BE-së dhe vendimmarrësja kryesore në krizën e euros, duhet të marrë përgjegjësinë e ndërhyrjes së BE-së në Ballkanin Perëndimor,

duke e mbështetur Kosovën. Ajo që Berlioni i propozoi BE-së të bënte me Shqipërinë 20 vjet më parë, ai tani duhet ta bëjë në emër të BE-së me Kosovën.

Të krijojë një “partneritet të veçantë dypalësh” i projektuar për të ringjallur ekonominë dhe shoqërinë e Kosovës. Pakti duhet të ketë në thelbin e tij një strategji 20-vjeçare për rimodelimin e plotë të peisazhit politik dhe ekonomik të Kosovës. Gjermania duhet të instalojë ekspertët e saj në departamentet kryesore të qeverisë kosovare. Ata duhet të përqëndrohen në çështjet ekonomike dhe sociale, të përshpejtojnë reformat e BE-së dhe të përpiqen të tërheqin investime reale nga vendet e BE-së.

Partneriteti i veçantë mund të jetë shtypa e duhur për ta realizuar këtë nismë. Koha për të marrë hapin e duhur është tani. Fati i Kosovës përfaqëson më shumë se vetë interesin kombëtar. Është një matës kuptimplotë i aftësisë së BE-së për të zhvilluar politikën e jashtme në lagjen e saj më të afërt. BE-ja, me gjithë problemet e veta, nuk do të dëshirojë fqinj si Ballkani Perëndimor në gjendjen e tanishme. Por as nuk mund të pretendojë se Ballkani Perëndimor nuk ekziston.

EU Observer, 16 gusht 2012

Serbia nuk do ta njohë Kosovën, bisedimet me BE-në nisin në mars 2013

Në vizitën e tij në Bruksel, kryeministri serb Ivica Daçiç u takua me zyrtarët e BE-së për të diskutuar përmbushjen e detyrimeve të dhëna para datës për fillimin e negociatave për anëtarësim në BE.

Rezultati ishte kërkesa nga ana e BE-së lidhur me statusin e Kosovës, përveç kërkesave konvencionale për reforma në sistemin gjyqësor, media, të drejtat e pakicave dhe luftën kundër korrupsionit. Pas takimit me Presidentin e Këshillit Europian, Van Rompuy, dhe Kryetarin e Parlamentit Europian, Schultz, u bë e qartë që këto dy institucione të BE-së do të mbështesin një anëtarësim të mundshëm të Serbisë në BE me kusht që Serbia të punojë drejt njohjes së Kosovës.

Kryeministri Daçiç deklaroi para mediave lokale se deklarata e Presidentit të PE, Schulz, që njohja reciproke qëndron në rrugën e anëtarësimit të



Serbisë ishte një mendim personal i bazuar në pikëpamjet e vendit të tij, Gjermanisë, dhe theksoi se gjatë bisedës me Schulz ai ia bëri të qartë se Serbia nuk do të ndryshojë qëndrimin e saj lidhur me Kosovën. Qëndrimi i Schultz u kundërshtua më vonë nga Komisioneri për Zgjerimin e BE-së, Fyle, i cili deklaroi se normalizimi i marrëdhënieve mes Beogradit dhe Prishtinës është i rëndësishëm, megjithatë, BE-ja nuk synon të insistojë që Serbia ta njohë Kosovën. Daçiç hodhi poshtë raportet kontradiktore të bisedimeve me zyrtarët e BE-së duke e cilësuar vizitën e tij si pozitive dhe konstruktive.

Diskutimi me BE-në vazhdon dhe qeveria serbe ka deklaruar se në mars 2013 pritet të jetë data e fillimit të bisedimeve zyrtare për anëtarësim.

Staffi i EuroSpeak, shtator 2012



Çfarë mendojnë europianët dhe amerikanët për njëri-tjetrin, dhe për botën?



Një studim vjetor publikuar nga German Marshall Fund i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, një think-tank prestigjioze, na njeh me

prirjet e fundit Transatlantike. Për realizimin e tij, janë anketuar 12 shtete, 9 të Bashkimit Europian (Suedia, Franca, Gjermania, Polonia, Holanda,

Britania e Madhe, Spanja, Italia, Rumania) plus Rusia, Turqia dhe Shtetet e Bashkuara.

Një gjetje deri diku e habitshme është se reputacioni i kapitalizmit është në rënie. Në Europë 76 për qind e të anketuarve mendonin se nga sistemi i tyre ekonomik kanë përfituar vetëm një pakicë e shoqërisë, ndërsa 64 për qind e amerikanëve e mendojnë kështu. Francezët kanë frikë nga Kina; ndërsa holandezët shohin shanse të mëdha tregtare atje. Barak Obama do të rizgjidhej shumë lehtë nëse europianët do mund të votonin, edhe pse ai gëzon më pak mbështetje në Europën lindore ish-komuniste. Në Poloni, dikur një mbështetëse e fuqishme e marrëdhënieve atlantike, mbështetja për udhëheqjen amerikane ka rënë ndjeshëm që nga viti 2011. Suedia shquhet në Europë si vendi me mendim më pozitiv në lidhje me ndërhyrjet e jashtme ushtarake të SHBA-ve (Afganistan, Irak, Libi). Rusia mbetet ultra-skeptike në lidhje me këtë çështje. Në tërësi gjykimet e Ruisë mbi Amerikën dhe Europën janë përkeqësuar, edhe pse ato mbi Bashkimin Europian mbeten ende mjaft pozitive.

The Economist, 15 shtator 2012

Kardinal Martini: Kisha ka ngelur 200 vjet mbrapa

Përpara se të shuhej më 31 gusht 2012, Kardinali Carlo Maria Martini, një personalitet i shquar i kishës katolike i njohur më së shumti për pikëpamjet e tij liberale dhe shpotitëse, ka dhënë një intervistë të fundit për gazetën *Corriere della Sera* e cila ngre pyetje të rëndësishme mbi pozicionin e kishës në botën perëndimore. Duke u shprehur se tashmë “kisha ka ngelur 200 vjet mbrapa”, ai shtron si të domosdoshëm shqyrtimin e disa temave mbi të cilat deri më tani ky institucion ka pasur qëndrim të ngurtë. Këtu përfshihen çështje si divorci, seksualiteti si dhe pranimi i faktit që kisha tashmë e ka humbur vëmendjen e besimtarëve në Europë dhe duhet të reflektojë si duhet t’i afrojë ata sërish. Sipas kardinalit, “kisha duhet të pranojë gabimet e veta dhe të nisë një ndryshim radikal, duke filluar nga Papa dhe peshkopët. Skandalet e pedofilisë na detyrojnë gjithashtu të ndërmarrim një udhëtim të gjatë transformimi.”

Staffi i EuroSpeak, shtator 2012



Karta Blu e Bashkimit European u mundëson personave të kualifikuar të jetojnë në një nga vendet anëtare

Ka disa vite që Bashkimi European po përpiqet të adresojë çështjen e plakjes së popullsisë si dhe konkurrencës në thithjen e emigrantëve më të kualifikuar nga vende si SHBA-ja, Kanadaja apo Australia. Për këtë qëllim, BE-ja tashmë ofron *Kartën Blu* (emri qartësisht frymëzohet nga *Karta e Gjelbër* që u jepet imigrantëve në SHBA). Kjo presupozohet të jetë një mundësi e mirë për personat më të kualifikuar të jetojnë dhe punojnë në një vend anëtar të BE-së nëpërmjet një procedure të unifikuar. Kushtet që duhen përmbushur janë ato të arsimit të lartë, pasja e një kontrate të paktën një vjeçare me një pagë e cila varion sipas specifikave të secilit vend. Karta Blu lëshohet fillimisht për dy vite dhe mund të rinovohet. Gjithashtu ajo mundëson zhvendosjen në një vend tjetër të BE-së.

Cilat vende ofrojnë Kartën Blu të BE-së?

Austria, Belgjika, Bullgaria, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Holanda, Hungaria, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Polonia, Portugalia, Qipro, Republika Çeke, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja dhe Suedia.

Karta Blu përbën një nisëm të re e kësisoj mbetet për tu parë në të ardhmen nëse ajo vërtetë do t'ia dalë t'u japë fund burokracive të tepërta në secilin vend anëtar. Aktualisht, ato pengojnë përthithjen e personave më të kualifikuar e për këtë BE-ja është vazhdimisht objekt kritikash. Për informacion dhe për të aplikuar: <http://www.apply.eu>

Stafi i EuroSpeak, shtator 2012

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) është një organizatë think tank e cila synon përmirësimin e cilësisë së debatit në lidhje me procesin e integritimit europian. Lëvizja shërben si forum për shkëmbimin e pikëpamjeve mbi sfidat politike, ligjore, ekonomike, dhe sociale me të cilat përballet Shqipëria në rrugën drejt integritimit europian. Lëvizja, në mënyrë analitike, vlerëson fenomenet në funksion të promovimit të ideve dhe instrumenteve që përmirësojnë procesin e integritimit europian. Studimet dhe dialogu mes aktorëve fokusohen në katër programe: Informimi dhe promovimi i vlerave europiane si dhe i procesit të integritimit europian të Shqipërisë; Demokracia dhe mirëqeverisja; Aspektet ekonomike dhe sociale të integritimit europian; Bashkëpunimi në nivel rajonal.

Realizimi i këtij buletini u mundësua me mbështetjen e Fondacionit Friedrich Ebert, si dhe Programit Europe for Citizens të Komisionit European.



Të gjithë numrat e EuroSpeak i gjeni dhe në faqen e internetit të Lëvizjes Europiane në Shqipëri. Nëse dëshironi të merrni rregullisht buletin EuroSpeak nëpërmjet postës elektronike, na shkruani në: info@em-al.org.

Për komente ose për të publikuar artikuj, mund të kontaktoni me kryeredaktoren, Blerta Hoxha, në adresën: blerta.hoxha@em-al.org